

Ambasadori turk në Shqipëri, Z.Tayyar Kağan Atay, vizitë në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Në vijim të aktiviteteve në kuadër të 100-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike Shqipëri-Turqi, Ambasadori turk në Shqipëri, Z.Tayyar Kağan Atay, vizitoi Universitetin e Elbasanit, ku u takua me rektorin Prof. dr. Skender Topi, si dhe zhvilloi një bashkëbisedim me studentë e pedagogë të universitetit.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Prof. Topi, theksoi nivelin e shkëlqyer të marrëdhënies Shqipëri-Turqi, bashkëpunimin e jashtëzakonshëm me universitetet prestigjioze në Turqi, në kuadër të programit Erasmus+, projektet e vazhdueshme të përbashkëta që kanë njohur rritje vit pas viti, si dhe mundësimin e studimit të gjuhës turke në Universitetin e Elbasanit.

Ambasadori Atay, shprehu vlerësimin e tij, për angazhimin e ndërmarrë nga Prof. Topi, për të krijuar hapësira dhe mundësi që gjuha turke të mësohet në Universitetin e Elbasanit, interesimin në rritje të të rinjve për ta studiuar, si dhe theksoi avantazhet që mund t'u ofrohen të rinjve që të ndjekin studimet universitare përmes bursave të plota nga cikli parë deri në tretin.





